

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**Dega e Letërsisë shqipe**



**Romani “Sikur të isha djalë”**

*(Punim diplome)*

**Mentori**

**Prof. ass.dr. Kamber Kamberi**

**Kanditate**

**Rina Eminaj**

**Gjakovë, 2017**

## KOMISIONI

**Kryetar**

---

**Anëtar**

---

**Anëtar**

---

**Nënshkrimi**

**Kandidate** Rina Eminaj

---

*Gjakovë, 2017*

## PËRMBAJTJA E TEMËS

<b>HYRJE</b> .....	3
<b>KAPITULLI I PARË</b>	
1. Jeta dhe veprimtaria e Haki Stërmillit .....	5
1.1. Jeta e shkrimtarit .....	5
1.2. Veprimtaria letrare .....	7
<b>KAPITULLI I DYTË</b>	
2. Romani.....	9
2.1. Sikur të isha djalë .....	10
2.2. Ndertimi i romanit .....	11
2.3. Subjekti i romanit.....	12
2.4. Raporti Dija-Shpendi .....	15
<b>KAPITULLI I TRETË</b>	
3. Të veçantat e personazhëve .....	17
3.1. Dija.....	17
3.2. Trekëndëshi i personazheve negativë.....	18
3.3. Roli i Shpendit në roman.....	19
3.4. Religjioni te personazhi Dajë Haxhiu .....	20
3.5. Roli i familjes së Xha Simonit .....	21
3.6. Roli i Irenës në formimin e Dijes .....	22
<b>KAPITULLI I KATËRT</b>	
4. Gjuha dhe figuracionet në roman .....	24
4.1. Gjuha e Dijes .....	26
<b>KAPITULLI I PESTË</b>	
5. Studiuesit albanologjik për romanin “Sikur të isha djalë” .....	28
5.1. Robert Elsie për romanin.....	28
5.2. Sabri Hamiti për romanin .....	29
<b>PËRFUNDIME</b> .....	30
<b>BIBLIOGRAFIA(Literatura)</b> .....	30

## HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i romanit “Sikur të isha djalë” të shkrimtarit tonë të njohur Haki Sternmillit, i cili bëri bujë të madhe me krijimin e kësaj vepre. Një roman që të bën ta përjetosh deri në palcë, sepse është realiteti i gjithëshfaqur i asaj kohe. Në këtë punim do të shtrohet po ashtu i gjithë mesazhi i autorit që ka në këtë vepër, duke e vlerësuar lartë mënyrën shkrimit në këtë roman se si arriti që një shkrimtar nëpërmjet personazhit femër të tregoj shumëçka. Do të bëj analizën e personazheve po ashtu do flas edhe për gjuhën që ka përdorur dhe figurat stilistike që ka futur në këtë vepër.

Ne këtë punim do të mundohem të futem sa më thellësisht dhe të jap më shumë nga vepra, sepse kjo vepër prek shumë aspekte të ndryshme si aspektin kulturor, historik, relegjionin etj. Kjo vepër bëhet zëri i mbytyr i një femre që kërkon dinjitetin e saj të plotë.

Stërmilli tërë jetën dhe punën ia kushtoi popullit dhe luftoi për një shoqëri demokratike e më vonë edhe socialiste. Stërmilli bëson që nëpërmjet letërsisë shumë gjëra mund të ndryshojnë në shoqëri sepse edhe e gjithë vepra e tij është fund e krye e marrur nga realiteti që ai i ka takuar, duke i kthyer ato në një gjuhë më artistike.

## KAPITULLI I PARË

### 1.Jeta dhe veprimtaria e Haki Stërmillit

#### 1.1. Jeta e shkrimtarit

Haki Stërmilli lindi ne Shehër të Dibrës më 17 maj 1895.Ishte shkrimtar, gazetar,kryetar i shërbimit sekret shqiptar në kapërcyelle të 1923-1924, partizan në luftën e dytë botërore, anëtar i KANÇ-it dhe përfaqësues i Dibrës në Kuvendin Popullor. Në shtyp dhe botime mbajti qëndrime lidhur me të drejtat e shqiptarëve andej kufirit, republikanizmit dhe të drejtave të femrave. Vepra e tij më e njohur është Sikur t'isha djalë(1936). Shehër të Dibrës ku mori mësimet e para, shkollimin e mesëm e nisi nëManastir por nuk mundi ta përfundojë për shkak të Luftës Ballkanike. Mbasi qyteti i Dibrës mbeti jashtë kufijve, Hakiu u vendos në Shqipëri dhe nisi punë si pjesë e administratës shqiptare. Në vitet 1915-1918 punon si sekretar krahinor në Mat dhe Peshkopi, pastaj si sekretar i parë i nënprefekturës së Matit, e gjithashtu mësues personal i motrave Zogolli<sup>1</sup>.

Në vitet 1920-1924 u përfshi në lëvizjen demokratike, më 2 shkurt 1922 Zogolli i propozoi Kryeministrit emrin e Hakiut për sekretar të shifrës. Këshilli i Naltë nuk e dekretoi Stërmillin, por pas një viti Zogolli ministër e dekretoi më 16 janar 1923 si sekretar i Sekretarisë Sekrete<sup>2</sup>. Propozimi do të miratohej nga Këshilli i Ministrave më 20 janar dhe 31 janar do të dekretohet nga Këshilli i Lartë. Si kryetar i Sekretarisë Sekrete, Hakiu qëndroi deri më 16 prill 1924, e u largua përfundimisht pas largimit të Zogollit dhe emërimit të Shefqet bej Verlacit kryeministër dhe Ministër i Brendshëm.

Pas Lëvizjes së qershorit, Hakiu merr pjesë në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të shoqërisë

---

<sup>1</sup> Wikipedia

<sup>2</sup>Wikipedia

"Bashkimi", ku u zgjodh sekretar i shoqatës dhe ku u rivendos Ll. Fundo kryetar. Me rikthimin e Zogollit dhe Triumfin e

Legalitetit mërgondrej Italisë, Francës, Austrisë, Gjermanisë, Polonisë dhe Lituanisë. Për një vit qëndroi në Bashkimin Sovjetik për katërmbëdhjetë muaj ku u takua edhe me Ali Kelmendin, bashkëpunoi edhe me KONARE-n . Më 1927 gjendet në Jugosllavi, ku qëndron në Manastir. Këtu më 17 mars 1929 në rrethana jo krejtësisht të sqaruara, dëbohet nga shteti jugosllav. I dorëzohet autoriteteve shqiptare në Bilisht, e vendosin në Korçë dhe pak ditë më pas në Tiranë ku e shoqërojnë në burg. Aty e takon miku dhe pasardhësi i tij në atë institucion që tashmë quhej Zyra Sekrete, Abedin Hoxha. Më 6 gusht 1929 dënohet me 5 vjet burg se kishte guxuar të propagandonte botërisht kundër regjimit dhe personit të Mbretit.

Më 28 nëntor 1933 në sajë të një telegrami që i kishte dërguar NMT Zogu I për amnisti, falet dhe lirohet. Pas lirit hapi një dyqan në rrugën Mbretnore, mbasi kishte bërë të mundur të punësohej te një firmë e huaj që shiste në Shqipëri llampat elektrike të firmës OSRAM. Shkruan më 6 prill 1939 "Ti leve o yll" për princin Leka<sup>3</sup>

Mbas pushtimit të Italisë gazeta "Fashizmi në listat e gjata botonte me nr. 44 edhe anëtarësimi e Haki Stërmillit në Partinë Fashiste, në të njëjtën ditë kur ishte anëtarësuar M. Kruja, B. Valteri, etj. Për Stërmillin shënohej se "merrej me punë private".

Në biografinë e tij shënohej se më 31 korrik 1943 ishte hedhur në ilegalitet, kur kishte qenë në Tiranë. Më vonë do të zgjidhej në organet paralele të pushtetit komunist, duke filluar nga mbledhja e Labinotit në shtator 1943 e deri në anëtar i dalur nga kongresi komunist të Përmetit. Përfaqëson lëvizjen komuniste në mbledhjen e Mukjes. Për këtë shkak u zgjodh më 2 dhjetor 1945 dhe më 28 maj 1950 deputet. Pas 1945 ishte kryetar i Frontit Demokratik dhe nënkryetar i Komitetit Ekzekutiv për Qarkun e Peshkopisë. Vdiq më 17 janar 1953 i sëmurë pas një lëngate të gjatë<sup>[2]</sup>, duke qenë edhe deputet i Rrethit të Peshkopisë në Kuvendin Popullor<sup>[1]</sup>, zëvendësuar prej Jashar Menzelxhiut.

---

<sup>3</sup>Wikipedia

## 1.2. Veprimtaria letrare

Krijimtaria letrare e Haki Stërmillit bie, kryesisht, në një periudhë të rëndësishme të shoqërisë shqiptare në periudhën e dy luftërave të mëdha botërore, apo, siç e quajmë shpesh, në periudhën e Pavarsisë shqiptare 1912-1939. Veprimarinë letrare Stërmilli e filloi si tregimtar dhe dramaturg.

Me gjithë veprimtarinë e tij si shef i parë i shërbimit inteligjent shqiptar, në kujtesën e njerëzve, Haki Stërmilli do të njihet më tepër si shkrimtar. Botoi veprat “Dibranja e mjerueshme” (1923), “Dashuni e besnikëri” (1923), “Agimi i lumnueshëm” (1924), “Burgu” (1935), “Sikur t’ isha djalë” (1936), “Trashëgimtarët tanë” (1950) ndërsa pas vdekjes u botuan ditari “Shtigjet të lirisë” (1966) dhe “Kalorësi e Skënderbeut” (1968).

Romani “Sikur të isha djalë” është ndoshta i vetmi roman, ndër më të lexuarit e të botuar në kohën e tij. Romani është një apoteozë e fuqishme artistike për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të femrës në veçanti. Ai zgjoi kërkësi dhe luajti një rol të pazëvendësueshëm në masën e lexuesve në të gjitha trevat shqiptare. Në vitet ’30, në vitet ’50 dhe deri në dhjetëvjeçarin e parë të Shek. XXI, romani ka njohur mbi 12 ribotime: në Tiranë, Prishtinë e Shkup, duke shënuar një rekord të paarritshëm në historinë e letrave shqiptare.

***Romani “Sikur të isha djalë” i bëri jehonë arsimimit e përparimit të gruas shqiptare, të shtypur dhe të nëpërkëmbur me shekuj.***

Romani “Sikur të isha djalë” ishte një jehonë e kësaj lëvizjeje shoqërore dhe një nga veprat ku ajo u pasqyrua më gjerë e në mënyrë të drejtpërdrejtë. Romani ka formën e një ditari, të mbajtur nga personazhi kryesor i tij, vajza e re, Dija. Nëpërmjet shënimeve të saj lexuesi njihet me jetën e përditshme të një familjeje të zakonshme qytetare shqiptare, ku ndihet edhe prapambetja e theksuar shoqërore, edhe pozita e mjeruar e gruas në familje, e cila duhet të bëjë një jetë të mbyllur brenda mureve të shtëpisë e atë sipas ligjeve patriarkale.

Interesimet e Stërmillit për punë intelektuale janë mjaft të gjera. Kështu, përveç krijimeve letrare, Stërmilli u muar edhe me përkthime, e përktheu nga frëngjishtja Një natë në Amerikë, pjesë e memoareve të Shatobrianit, romanin Gjarpri i dashunisë të Muhsin Serezit, shkrimtar turk me origjinë shqiptare, e të tjera. Bëri një punë të vlefshme edhe në fushën e letërsisë popullore. Në

këtë fushë Stërmilli mblodhi me kujdes këngë popullore dhe i botoi në Visaret e Kombit, vëllimi XIV , në Tiranë,1944 me titull Fyelli i Dibrës, si dhe një numër të madh përrallash,fabulash,e gjëegjeshash,që ruhën në dorëshkrim më titull Rranze votres dibrane në Institutin e Folklorit te Tiranës,një numër i madh i të cilave është botuar në ‘Folklori shqiptari I,proza popullore’,vëllimi i dyte,Tiranë,1966 dhe në ‘Folklori shqiptar gjëegjeza’,Tiranë,1968. Mandej Stërmillit i interesoi,madje shumë,edhe historia,gjuha dhe kritika letrare.Në lëmin e histories shkroi veprën ‘Dibra në prag të historis’,Tiranë,1940. Veprimtarinë letrare Stërmilli e filloi në vitin 1922,kurse në vitin 1923 u paraqit me punimet e para letrare.Së pari filloi me tregime dhe,pas 5-6 muaj i botoi dy dramet.Në burg Stërmilli shkroi ditarin ‘Burgu’, e filloi romanin ‘Kalorësi i Skënderbeut’.Pas lirimit nga burgu,Stërmilli vazhdon veprimtarinë letrare boton ditarin ‘burgu’ 1935,romanin ‘Sikur të isha djalë’ 1936,shkruan ditarin ‘Shtigjet e lirisë’, boton dramën ‘Trashegimtarët tanë’.



## KAPITULLI I DYTË

### 2. Romani

Historia e zhvillimit të romanit në gjuhën shqipe është i shkurtër. Ajo fillon kah mbarimi i shekullit të XIX e në fillim të shekullit të XX për të gjalluar disi deri në vitet e 60' të këtij shekulli.

Zhvillimi i romanit më të ndërlikuar letrar, e kushtëzon, më shumë se format e tjera letrare, zhvillimi i përgjithshëm kombëtar i popullit të caktuar, ai shkon paralel me zhvillimin e gjithëmbarshtëm të popullit dhe është shprehje e këtij zhvillimi të cilin, në rastin tonë, për shumë shekuj e penguan rrethana të ndryshme historike. Shkaqet politike-shoqërore e kulturore-intelektuale nuk qenë shumë i volitshëm, nuk i dha shumë krah zhvillimit të romanit deri tashti vonë. Romani “Bardha e Temalit” (1890) të Pashko Vasës, u botua në gjuhën frënge ajo nuk njihej në mjedisin shqiptar. Romanet historike të Ndic Nikajt të cilat duke shikuar nga kriteret e sotme poetik, vështirë të quhën romane. Menjëherë pas këtyre kemi prozat e gjata të Mihal Gramenos e të Foqion Postolit. Në periudhën midis dy luftërave botërore, u ndie nevoja për zhvillimin e romanit, përmes secilës mund të shtroheshin e të trajtoheshin shumë çështje si ato të ditës, problemet që shoqëria i ndiente. Por ajo se çfarë i mungonte krijuesve ishin modelet në letërsinë shqiptare, krijuesit e kishin shumë të vështirë dhe kjo punë kërkonte mund të madh. Stërmilli njihte gjuhën turke, frëngjishten, italishtën, serbokroatishtën, kurse në emigracion e mësoi mirë edhe gjermanishtën e rusishtën, kështu që në origjinal i lexoi veprat sidomos ato frënge, italiane, gjermane e ruse. Këto i ndihmuan Stërmillit të merret me prozën e gjerë si dhe në këtë fushë i la trashigimisë letrare shqiptare dy romane të botuara, Sikur të isha djalë, Kalorsi i Skenderbeut. Në vitin 1936, pikërisht më 28 nëntor u lëshua në qarkullim romani i parë i Stërmillit me titullin “Sikur të isha djalë”, e cila i dha vullnet për librin e ardhshëm.

#### 2.1. Sikur të isha djalë

Në periudhën e Pavarsisë shqiptare 1912-1939, e sidomos pas Kongresit të Lushnjës

1920, çështja e emancipimit të femrës shqiptare u bë çështje e ditës. Idetë revolucionare për të drejtat e gruas në shoqëri u rritën në lëvizje revolucionare shoqërore për mbrojtjen e femrës sonë. Vite më parë dhe pikërisht në kohën para e pas Revolucionit Borgjez Francez 1789 lindi dhe u zhvillua në botë ashtuquajtura Lëvizja Feministe. Kjo lëvizje zuri fill në vendët ku filloi të zhvillohet vrullshëm industria që kërkonte fuqi të reja punë. Borgjezia dhe industrialistët, nën parullën e luftës për të drejtat e barabarta të femrës dhe të mashkullit, kryenin punën e tyre për t'i tërhequr femrat nga punët e shtëpisë në fabrikat që shumoheshin me ritëm të shpejt. Për femrat e shtresës borgjeze kërkoheshin arsimit si dhe e drejta e votës ndërsa për ato femrat të shtresave të ulëta mjaftonte vetëm fitimi i të drejtës për të punuar edhe në fabrika. Çdo herë e më shumë kjo lëvizje merrte vizione më të qarta të cilat kishin baza sa më të shëndosha sociale e humane.

Në realitetin shqiptar nuk mund të flitet për një lëvizje të tillë as në mbarim të shekullit të XVIII e as në shekullin XIX dhe asnjëherë më vonë, sepse kjo çështje nuk vinte në vijën e problemeve parësore sepse vendi ishte i poshtuar nga okupatori i huaj dhe kishte probleme të tjera me të rënda. Interesimi rreth kësaj çështje u bë vetëm pas formimit të shtetit të pavarur shqiptar. Lëvizje feministe nuk kishte në botën shqiptare si ato lëvizjet e tjera që kishte patur në vendët e tjera të zhvilluara. Për të drejtat e gruas shqiptare në shoqëri ka baza të shëndosha njerëzore dhe mbështetje fuqishëm në vetëdijën kombëtare. Problemi i pozitës së femrës shqiptare u shtrua si problem social që kërkon zgjidhje të shpejtë e të drejtë. Mandej, pozita e gruas në shoqërinë shqiptare u pa edhe si problem politik-patriotik i lidhur ngushtë me mbrojtjen, me sigurinë e me prosperitetin e vendit. Kjo çështje u shtrua nga intelektualët e patriotët me orientim demokratik dhe u pa jo vetëm si çështje humane, por edhe si domosdoshmëri e lidhur me qënien kombëtare e shtetërore. Dhe kështu ky problem i emancipimit të gruas u trajtua edhe në letërsi dhe sidomos në vitet e '30. Shkrimtarët që trajtuan këtë problem si Migjeni, Spase, Stërmilli, Bulka, Varfi, Cepa, Ramiz Harxhi, Ollga Pllumbi, Selim Shpuza, Halim Xhelo, Naum Prifti, e të tjerë shkruan më shumë guxim e me argumente për të drejtat e gruas, vendin e saj në shoqëri, barazimin e të drejtave të gruas me burrin në të gjitha format e jetës, arsimimin e tij. Haki Stërmilli me romanin e tij "Sikur të isha djalë" tronditi vendin shqiptar me të. Më 28 nëntor të vitit 1936 u vu në qarkullim

romani i botuar nga shtëpia botuese Ora e Tiranës.

Sterjo Spasse<sup>4</sup> patë thënë se i bëri kombit urimin më të bukur për 28 nëntor i dhuroi romanin deri atëherë më të mirë në letërsinë shqipe, i cili në shenjë dhimbjeje i kushtohet shpirtit të atyre femrave fatzeza që bani flia e fanatizmes verbuese dhe e zakoneve tona të egra. Libri u pëlqye shumë nga bota shqiptare shumë individ kërkuan ribotimin e librit “Sikur të isha djalë”.

Ribotimin e mori përsipër Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi” e Tiranës, e cila në vitin 1938 e nxori në tirazh prej 5000 ekzemplarësh. Romani u luajt edhe nga shumë grupe amatorësh e gjysmëprofesional e profesionale teatrale e gati në të gjitha mjediset shqiptare. Ky libër pati jehonën më të madhe ndër romanet letrare shqipe. Çështja e emancipimit të femrës shqiptare ishte ndër çështjet më aktuale në vitet e 30, e cila u trajtua nëpër shtypin e kohës si Bota e Re, Rilindja, Drita, Shtypi e të tjera.

## 2.2. Ndërtimi i romanit

Ndërtimi i këtij romani është bërë mbi temën e robëris së femrës shqiptare, prapambetja dhe dëshira e saj për tu liruar nga shtypja shoqërore, temë kjo që për shumë vite që aktuale dhe në përmasa më të vogla vazhdon të jetë aktuale edhe sot në disa mjedise. Fati i Dijës ishte fati i femrave shqiptare. Fati i Dijës ishte në dorën e fanatizmit i injorancës. Dija në këtë roman thërret për drejtësi, një thirrje që shkakton shumë dhimbje gjatë të lexuarit të romanit. Tema në roman është një dramë e rënde, një luftë e zhvilluar midis forcave të pabarabarta. Dija e sheh të domosdoshme arsimimin e femrës, e cila kjo dëshir nuk i plotësohet asaj personalisht por i jep një ndihmes rrugës së emancipimit të gruas shqiptare.

Romani “Sikur të isha djalë” është shkruar në formë ditari. Kjo formë letrare i mungonte prozës sonë. Stërmilli e kultivoi këtë formë më mjaft sukses. Në këtë roman kemi një monolog dramatik i gjendjes, i dhimbjes së personazhit. Rrëfimi bëhet në vetën e parë, formë që të ofron mundësi më të mëdha për të depërtuar në psikologjinë e personazhit. Ngjarja realizohet në kohën e tashme. Të

---

<sup>4</sup>Ibid

shkruarit e këtij romani në formë ditarit të jep përshtypje që Dija ka ekzistuar më të vërtetë dhe këtë ditar e ka ruajtur në formë dokumenti.

Ngjarja e romanit “Sikur të isha djalë” zhvillohet në mënyrë kronologjike dhe fillon me shtatë mars të një viti të viteve '30 e vazhdon deri në njëzet e katër prill të vitit pasues, domethënë brenda trembëdhjetë muajsh e shtatëmbëdhjetë ditësh duke përfshirë kryesisht moshën shtatëmbëdhjetë e tetëmbëdhjetëvjeçare të Dijës.

Në këtë roman na jepët retrospektiva dhe introspektiva të cilat bëhen domosdoshmëri strukturore të romanit sikur të isha djalë. Stërmilli i mori personazhet dhe ngjarjet e romanit të vet nga ambienti të cilin e njeh mirë dhe kjo njohje e realitetit jetësor i ofroi mundësi të mëdha të skalisë personazhe të gjalla, autentike, që na duket se i njohim, se i kemi takuar në jetë, se i kemi dëgjuar brengat e vuajtjet e tyre. Ndërtimi i romanit është i ndërtuar nga preokopimet e vajzës në raport me shoqërinë që e rethonë atë, kundërshtitë në mes forcave progresive dhe atyre forcave primitive e konservative

### **2.3. Subjekti i romanit**

Sipas romanit, Dijës i kishte vdekur e ëma qysh kur ajo kishte qenë në moshën katër vjeçare. Nëna e saj vdiq e re ende pa i mbushur njëzet e tri vjet. Pas vdekjes e së ëmës, babai i Dijës u martua me një grua tjetër edhe pse Dija nuk e deshti këtë gjë. Njerka filloj ta argëtonte Dijën me dhelpërinë e saj, por Dija nuk donte që ta argëtonte ajo dhe iku me vrap tek dhoma e saj për të fjetur. Kur u zgjua në mëngjes, Dija pa se në dhomën e bukës gjindeshin babai i saj, njerka dhe Hallë Hatixhja. kur hyri brenda në dhomë Dija, Halle Hatixheja i tha asaj se prej sotit këtë grua e ke nënë. Në atë moment Dija bërtiti “Joooo” ajo s’është nëna ime- dhe ra duke qajtur në prehër të babait të vetë. Mbas martesës së dytë (me njerken) babai i Dijës ndërroi qëndrimin e vet kundrejtë saj. Dhe as që kujdesej të merrte vesh se si sillej njerka me të. Shpifjet që i bënte njerka atij i dukeshin qortime të mira. Gjendja e saj u vështirësua edhe më shumë kur u lind vëllau Rizai, sepse babai i saj nuk u kujdeste më për Dijën po më shumë për djalin. Kur i mbushi Dija 7 vjet babai i saj vendosi që ta dërgonte në shkollë. Një ditë prej ditësh kusheriri i Dijës e Hamiti e mori Dijën dhe shkuan bashkë në

shkollë. Jeta shkollore Dijes i pëlqeu shumë, sepse mësueset kujdeseshin si nëna dhe aty Dija gjeti shumë shoqe. Zonjusha Maria Freni njëra ndër mësueset e argëtonte dhe e këshillonte Dijen se si të sillej me prindërit. Dija kur u zgjonte në mëngjes për të shkuar në shkollë, sipas porosisë që e kishte mësuar mësuesja, ia puthte dorën babait dhe njerkes. Nganjëherë kur u përgatite Dija për të shkuar në shkollë, njerka i thoshte hajde më shporru se nuk je duke shkuar nuse. Disaherë nuk e linte të shkonte edhe në shkollë, e mbante në shtëpi për ta përkundur Rizain e më vonë Feriden e të tjerët. Një ditë kur shkoi në shkollë nuk e la ti mbathte këpucët dhe ia dha që ti mbathte nallet (sandallet, papuqe të maruara nga druri). Atë ditë binte nga pak borë dhe kur e pa Hamiti nuk e la që të shkoj në shkollë dhe e mori në shtëpi të vetë. Njerka i fliste babait të Dijes që ta ndalte Dijen prej shkolle por ai nuk ia pat vu veshin njerkes. Irena shoqja e Dijes, bija e Xha Simonit e kishte mbaruar shkollën fillore dhe donte me e ndjek një shkollë më të lartë. Edhe Dija dëshironte që të vazhdonte një shkollë më të lartë, por nuk e la babai i saj sepse ashtu e kishte mësuar njerka, i thoshte babait të saj që ta mbulonte Dijen me çerqaf se tash është bërë e madhe dhe duhet që të mbulohet. Babai i Dijes e kundërshtoi po ajo e bindi. Mbas disa ditësh e ndaluan prej shkollës dhe ia veshën një çerqaf të zi. Dijen mbasi e kishin ndaluar prej shkolles, njerka e shtynte që t'ia bënte të gjitha punët e shtëpisë si të rëndat ashtu edhe të lehtat . Dija pasi i bënte të gjitha punët ajo shkonte të shoqja Irena, sepse ajo i jepte libra për të lexuar.

Një ditë ishte bërë oxhaku i shtëpisë pa fshirë dhe njerka i tha Dijes që ta fshinte, por ajo kundërshtoi dhe iku të Xha Simoni, babai i Irenës, sepse ajo nuk mundte ta fshinte, ngase frikësohej se mos rrëzohet. Kur erdhi babai i Dijes nga puna e thirri Dijen disaherë, por ajo nuk iu përgjigj. Më vonë Dija shkoi në shtëpi, babai i saj i bërtiti se pse si kishte ndihmuar njerkes. Ajo ia tregoi të gjitha atij , që ajo i kishte bërë të gjitha punët, por kur njerka i tha që ta fshi oxhakun ajo nuk e degjoi sepse ajo nuk mundte. Atëherë babai i Dijes shkoi dhe e thirri një shërbëtor për ta fshirë oxhakun dhe i tha Dijes që nuk do të punosh më ti, njerka u nxi prej inati. Tani Dija është e lirë dhe shkon shpesh të Irena për të luajtur dhe lexuar bashkë më të libra të ndryshme. Një ditë në mëngjes Dija duke i krehur flokët para pasqyrës e pa veten ku e kishte vlarë ballin dhe iu kujtua rasti duke ecur në dhomë i kishte zënë këmba në qelim (tepi i

vjetër) dhe u rrëzua, dhe njerka i tha plaq se më trembe dhe ia mëshojë me grusht. Dija u përplas për toke duke qajtur, njerka i thoshte bollë më dhe e mori një spec te djegës dhe ia futi në gojë. Dijes edhe pse i dhimbte varra ajo nuk guxonte të qante, por tanimë Dija është bërë e madhe 17-18 vjeçare dhe nuk frikësohet më prej njerks.Një ditë Dija shkoi për të marrë një liber te Irena për të lexuar,sepse ishte mërztur shumë dhe aty e pa Shpendin. Në atë çast Dija e tronditur nga bukuria e Shpendit (një djalë i ri me prejardhje nga Kosova që kishte vetëm nënën Hijen dhe motren Fijen) e mori librin dhe iku menjëherë. Një ditë Irena shkoi për me ndejt te Dija dhe i tha Dijes se më ka pyetur Shpendi për ty. Dija u bë se nuk i interesonte fare. Një tjetër ditë Dija shkoi te Hallë Hatixheja dhe atje ndejti tri ditë. Aty e kishte parë Xhevrijen dhe ajo i kishte thënë se e dua një djalë të quajtur Shpend. Dija kur i tha Xhevrija ato fjalë u merakos, dhe mendoi se Shpendi do vetëm të luaj me mua. Prapë Dija shkoi te Irena për ta marrë një libër tjetër se shumë i pelqente librat dhe atje përsëri kishte qenë Shpendi në skajë të dhomës që Dija nuk e kishte parë fare. Dhe Dija shkoi drejtë bibliotekës ku kishte qenë Irena, dhe i tha Irenes më jep një liber tjetër se jam mërztur. Pasi mbaroi fjalet Dija,Shpendi kërceu me fjalë: Jepja një libër me poezi. Dija u tremb dhe mori librin që i dha Irena dhe deshti të ikte menjëherë. Irena i tha që të rri , ajo nuk deshti dhe Shpendi i doli përpara dhe i tha: rri, pse ik prej meje? ç'të kam bërë unë që nuk rri. Ndërhyri Irena dhe tha: rri Dije rri se Shpendi të do ty. Rrini ju në dhomën time se unë po shkoj të shikoj se mos po vie ndokush. Ata biseduan për shumë gjëra dhe lindi dashuria mes tyre. Nga dhuna që iu është bërë Dijes nga njerka ajo sëmuret edhe nga tuberkulozi. Ajo i tha babait që ta sjellte një mjek por ai nuk e sjelli. Mëmë Gjystina, nëna e Irenës kishte folur me nënë e Shpendit për dashurinë e tyre dhe vendosen që ta lypin të babai i Dijes, por ai nuk e degjoi , shkoi edhe Xha Simoni që ta bind, por ai përsëri nuk e dha. Dijen e kishte lyp një tregtar dhe babai i saj vendosi që ta jepte te ai tregtari pa e pytur Dijen fare se a i pëlqen asaj apo jo. Dijen duan ta martojnë sa më shpejtë me atë tregtarin e pasur afër 40 vjet, por ajo u sëmua nga tuberkulozi dhe e shtyjnë dasmën. Babai i saj e thërret një doktor, dhe kur vjen ai doktori ta mjekojë Dijen, e shikoi se ç'kisht, por u largua pa treguar asgjë Dijes. Më vonë erdhën edhe dy të tjerë e shiquan se ç'kishte dhe flisnin në mes veti frengjisht që ajo ishte e sëmur nga tuberkulozi një sëmundje e pashërueshme. Dija foli ne gjuhën

frenge me dy doktorë dhe tha: “Unë e kuptoj se sëmundja ime është e pashërueshme, por ju mos u lodhni shumë me i zgjedhë barnat që do të m’i jepni as edhe mos u shqetësoninga vdekja e ime, se unë do të jem më shumë e kënaqur nga vdekja se sa nga rrojtja”. U habiten mjekët dhe e pyeten Dijen se a e kupton ti frengjishten? Ajo u pergjigjë pak sa për t’u marrë vesh. U munduan për ta përmirësuar gabimin dhe thanë se në vetëm dyshuam se nuk jeni të sëmuar nga ajo sëmundje. E pershëndeten mjekët duke e porositur që të mos dëshpërohet dhe shkuan. Shpendi i kishte derguar një letër Dijes që të arratisen në Itali dhe ajo u pajtua, kur arritën në Durrës hyjnë në hotel dhe presin barkën që do të vij me t’i marrë. Ata shohin një barkë dhe një njeri që po vie drejtë tyre. Në atë moment thërret dikush! Ndaluni dhe ai njeriu që ishte duke ardhur me barkë u kthye prapa dhe e zurën Shpendin dhe Dijen policia. Dijen e sollën në shtepi, ndërsa Shpendin e futën në burg. Dija i tha Shpendit se në momentin kur të shkeli në pragun e atij tregtari do ta mbys veten. Por Shpendi i tha jo mos e mby të veten se nëse e mby të ti veten atëherë edhe unë do ta mbys veten dhe nëna ime do të mbetet vetëm me motrën. Dija meqë ia kishte dhënë fjalën Shpendit nuk e mbyeti veten, por vdiq nga tuberkulozi. Dija para se të vdiste i kishte dhenë Hamitit ditarin e vetë dhe një shamijë të bardhë dhe i kishte thënë se mbasi ta lexosh jepja Shpendit. Dhe i kishte porosit që ta mbrojnë femrën shqiptare.

## **2.4.Raporti Dija-Shpendi**

Kush është Shpendi dhe pse nuk realizohet dashuria e tij me Dijen edhe pse të dytë janë të gatshem të rebelohen kundrejt zakoneve të kohës dhe të flijohen për njeri-tjetrin. Dija është vendase, kurse Shpendi një kosovar, që pas luftimeve me serbët ku humb babanë dhe vëllezerit arrinë në Shkodër që të vazhdoj shkollimin dhe të rimarrë jetën. Ai i bukur i mençur e i guximshëm, madje ideal në sytë e Dijes; është i papëlqyer për babanë e saj, pikërisht sepse është kosovar dhe i huaj, pse nuk është tregtar dhe qyqar. Edhe vet prova e ikjes se tij bashkë me Dijen për Itali dhe dështimi i saj para policies shqiptare është një tregues i fatit tragjik. Edhe vet udha jetësore e Shpendit është tragjike: arratiset nga vendlindja, nuk mund të realizojë dashurinë në

Shqipëri, dhe kërkon shpëtimin në ikje të re, përtej botës shqiptare. Tregimi i dashurisë, i Dijes, nuk ndërtohet sipas skemës së ndërhyrjes së personit të tretë, por simbas ndërhyrjes së kodit të dhunshëm të jetës. Lidhjen dashurore të Dijes me Shpendin nuk e prish personi i tretë i dashur, por personi, burri, i cili hyn përdhunshëm në këtë raport, vetëm për të përshpejtuar vdekjen e Dijes, pra tragjedinë. Raporti i ëndrrës së dashurisë dhe i realiteteve jetësore të Dijes merr fund me një frazë të saj: “Sot nuk jam më virgjeneshë”, që është frazë tragjike sepse thuhet mbasi është e shtruar përdhunshëm në shtratin e burrit të zgjedhur përdhunshëm. Dijsa në roman Shpendit i jep një përshkrim, thotë: Tip i çuditshëm dhe i përsosun. Një tip që ka bashkue në vete bukurinë dhe egërsinë, ëmbëlsinë dhe ashpërsinë, butësinë dhe vrazhdësinë, i mbylla sytë që të mos e shof, por nuk mbyllen sytë e mendjes e të zemrës, ajo preku me një fuqi tërheqëse. Me martesën e saj të dhunshëm, tanime Shpendi nuk është shpëtimi as në ëndrren dashurore as në ëndrren e ikjes.



## KAPITULLI I TRETË

### 3. Të veçantat e personazhëve

Stërmilli i mori personazhet dhe ngjarjet e romanit nga ambienti të cilin e njeh shumë mirë, ata i mori nga vet realiteti të cilit i ka përkasur vet autori. Stërmilli është dëshmitar i vuajtjeve të grave si dhe dëshmitar i patriarkalit shoqëror. Dija një personazh fatkeq e cila u la jetime që në moshën katër vjeçare, ajo tanimë ka vetëm një shoqe-Irena dhe kjo vetëm pse ishte fqinje e saj. Dija ka nevoj për përkrahje, për mbrojtje. Askush nuk është në gjendje t'i ndihmojë edhe pse ka mjaft njerëz që e duan dhe që u dhimbset- si vëllezërit e motrat nga babai, dajallarët e sidomos Daja Haxhiu, pastaj kusheriri Hamit Kërthiza, halla, tezet, familja e Xha Simonit, fqinjët e tjerë dhe të gjithë ata që e kanë njohur, por për t'i ndihmuar, s'mund t'i ndihmojë askush. Me sjelljet e babait e të njerks së Dijes nuk pajtohen të afërmit e tjerë të saj dhe dashamirët e fqinjë e familjes Kërthiza. Të gjithë ata i gjykojnë sjelljet e tyre ndaj Dijes, por për çudi, askush nuk ndërmerr ndonjë aksion për t'i ndihmuar Dijes. Me sjelljet e Sule Kërthizës e të njerks së Dijes nuk pajtohen as hallat, as dajallarët e as tezet e Dijes, as farefisi më i largët i saj, as fqinjët e as dashamirët e tjerë, por për fat të keq, asnjë prej tyre nuk ndërhyjnë në mënyrë të vendosur për të ndikuar që të ndryshohet qëndrimi i babait e i njerks ndaj Dijes. Ata sikur e ndiejnë vetën se s'kanë të drejtë, sikur ndihen të pakompetencë të përzihen në raportet baba-bijë e njerks-thjeshtë, prandaj janë vetëm soditës keqardhës të asaj që zhvillohet në familjen e Sulë Kërthizes.

#### 3.1. Dija

Stërmilli e hulumtoi Dijen në shumë aspekte. Ai depërtoi edhe në ndjenjën religjioze të saj dhe vërejti se janë koncepte mjaft liberale lidhur me religjionin. Kështu, disa kufizime që i bëhen femres, Dija nuk ia dedikon fesë, perkundrazi, ajo mendon, si edhe Dajë Haxhiu, se feja nuk e pengon zhvillimin e shoqërisë dhe nuk u sjell njerëzve vuajtje as shpirtërore e as fizike, kurse sjelljet e të atit e të njerks, disa adete dhe morali i kohës, mendon Dija, i shkojnë ndesh

fesë. Ajo është e bindur se religjioni i mirëfilltë e çon përpara shoqërinë. Meqë romani është shkruar në formë ditari, në të cilin Dija flet për jetën e vet, është e kuptueshme, prandaj, që ajo t'i kushtojë më shumë kohë e vend jetës personale, aq më parë kur ky ishte edhe qëllimi kryesor i saj, shprehimisht i shkrimtarit. Megjithatë, me disa vija të forta e karakterisitke janë revizuar edhe personazhët e tjerë, kush më pak e kush më shumë, si p.sh. njerka, babai i Dijes- Sulë Kërthiza, Shpendi, Dajë Haxhiu, kushërirri Hamit Kërthiza, Irena, familja e Xha Simonit, nëna e Shpendit-Hija, Qazim Krandja e ndonjë tjetër.

### 3.2. Trekëndëshi i personazheve negativë

Vetëm tre personazhe negativë kemi në këtë roman në formë ditari-njerka, babai dhe burri i Dijes. Të këto personazhe Stërmilli ka grumbulluar shumë veti negative të njerëzve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Stërmilli sintetizon në personazhin e njerkes, të babait e të burrit të Dijes pikëpamjet primitive, injorancën, fanatizmin, egoizmin mentalitetin mikroborgjez të shoqërisë shqiptare midis dy luftërave, që qeverisej shumë prej adeteve primitive se sa prej kodeve të një shoqërie të civilizuar. Stërmilli kujdeset t'i skalisë karakteret e personazhëve në harmoni me pamjen fizike të tyre, kështu, shpirti kazmë të njerkes, një gruaje pa ndjenja njerëzore, xhahile e katile i shkon për bukuri trashamania fizike, që shpreh edhe trashamaninë mendore të saj. Trupi dhe sidomos fytyra e saj prej idioeteje shprehin botën e brendshme të katilleshës e të injorantës. Ajo sillet në mënyrë mizore ndaj Dijes, e torturon në forma të ndryshme, ia copëton trupin dhe shpirtin. Me Dijen dhe me njerken e saj Stërmilli ka krijuar dy antipode në të gjitha aspektet e qenies e të jetës njeriut dhe kështu aplikoi metodën bardh-zi të skalitjes së personazheve. Derisa në personazhin e Dijes ka ngjeshur Bukurinë shpirtërore e fizike, në personalitetin e njerkes ka grumbulluar të gjitha të këqijat morale të karakterit fizike dhe në këtë mënyrë, derisa në rastin e parë kemi një personalitet të mrekullueshëm, në rastin tjetër – të dytë është dhënë një personalitet njeriu me shpirt e me trup bishe. Njerka e Dijes me asnjë element nuk është e denjë të jetojë jo në bashkësi familjare, por as në shoqërinë njerëzore. Babait të Dijes- Sule Kerthizes i kushton edhe më pak kujdes. Stërmilli na jep pak informata si të jashtme ashtu edhe të brendshme. Sulë Kërthiza është një tregtar injorant. Potretizimi i tij në roman nuk ofendohet e as nuk rëndohet shumë edhe pse për të gjitha të këqijat që i bëhen Dijes ai është më së fajtori aty. Një njeri i pasur, sipas tij, është i ndershëm, i mençur, i dashur, i

pëlqyeshëm dhe i nderueshëm. I edukuar në shoqërinë e vet, Sulë Kërthiza kishte formuar bindjet dhe mendimet e veta për raportet e caktuara shoqërore.

Ai prandaj nuk është i vetdijshëm për krimin që është duke i bërë dashurisë së Dijes ndaj Shpendit dhe duke e fejuar e duke e martuar të bijën me atë të cilin jo vetëm që nuk e dashuronte, por edhe e urrente. Sado që Dija përpiket, herë në menyrë të vetëdijshme e herë në menyrë të ndërëdijshme ta paraqesë të atin si produkt shoqëror dhe të mos e atakojë atë si një individ, prapëseprapë del në shesh karakteri i dobët, individual i tij.

Ky Sulë Kërthiza kategorik, i rreptë, e të themi, i vendosur në raport me të bijen, është krejtësisht tjetër në sjellje e në qëndrime me të shoqen. Ai, në raport me të, jo vetëm, që lëshon pe, por tërhiqet nga disa kërkesa të arsyeshme, por është edhe inferior edhe në pikëpamje intelektuale, prandaj s'është në gjendje t'i kuptojë dredhitë e grackat e të shoqes në dem të Dijes, kështu që Dija thotë, "*shpifjet që trillon njerka për mue atij i dukeshin si qortimet apo këshillat e Hazreti Hatixhe*"<sup>5</sup>. Fjala babë për Dijen nuk e ka më semantikën e mëparshme. Tashti Dija e gjurmon të atin edhe në aspektet e tjera dhe e gjen më shumë te meta në karakter dhe në përcaktim ideo-politik. Ajo e vë në dyshim edhe ndjenjën patriotike të tij, i cili, i verbuar nga fanatizmi dhe interesi material, nuk çan kokën fare për çështjen e atdheut, është indiferent ndaj ngjarjeve politike e shoqërore, përveç mirëvajtjes së dyqanit, nuk i intereson asgjë tjetër. Prandaj, Dija habitet se si ka mbetur në shtëpi të tyre, pa e vënë pa kujdes në një qoshe, shqiponja e flamurit, të cilën i ati e mbante vetëm pse nuk kishte guxim ta hiqte.

### 3.3.Roli i Shpendit në roman

Stërmilli e skalit me pak vija personazhin e Shpendit ashtu siç vepron. Shpendi ka mbetur i paskalitur sa duhet. Ky djalosh, që luftoi me trimëri, që u shkakton mandej, Dijes, në të njëjtën kohë, gëzime e hidherime, kënaqesi e vuajtje, që i hap horizonte të ndritura dhe e robëron, që ka ambicie të vazhdojë studimet e të bëhet i vlefshëm për shoqëri, në përjetimet dramatike të Dijes dhe në aksionet që deshi, por nuk i ndermori, ka mbetur i zbehtë. Atij tashti u mungon po ai guxim e ajo shkathtësi që e kishte verifikuar duke kaluar kufirin shtetëror. Tashti, në ambient tëri,

---

<sup>5</sup>Aty, f.47

Shpendi e ndien veten si të huaj dhe ky fakt e pengon të organizojë e të ndermarrë ndonjë aksion efikas për shpëtimin e Dijes. Pastaj, Shpendi nuk ka ideale me kuptime të gjera siç i ka Dija. Atij momentalisht i intereson vetëm personaliteti i Dijes e jo edhe çështja e emancipimit të femrës shqiptare në përgjithësi. Për këtë Shpendi nuk kishte as aftësi e as kohë. Atij i lindi ideja e ikjes nga Shqipëria së bashku me Dijen. Këtë ide nuk e realizoi dot për shkak të paaftësisë organizuese dhe për shkak të rrethanave më të vështirë në krahasim me ato kur iku nga vendlindja, prandaj përfundon shumë keq-burgoset. Me gjithë luftën që pat bërë duke kaluar kufirin, me gjithë plagen që pat marrë me këtë rast, Shpendit i mungoi revolucionariteti, i mungoi guximi, i mungoi ideja dhe aftësia për realizimin e saj që të kontribojë për transformimin shoqëror, për ndryshimin e pozitës së femrës dhe për sendertimin e dashurisë së madhe për Dijen.

### **3.4. Religjioni te personazhi Daje Haxhiu**

Më shumë se të Shpendi, në personazhin e Daje Haxhiut Stermilli shartoi elemente autobiografike shumë të rëndësishme. Edhe emrin e tij HAXHI, Stërmilli nuk e mori rastësisht. Struktura tingullore e grafike e emrit të këtij personazhi dhe e emrit të shkrimtarit-HA(XH)I-HA(K)I është gati e njëjtë dhe me të shqiptuar të emrit të tij-Haki dhe anasjelltas. Edhe pse fetar Dajë Haxhiu ka pikëpamje të përparuara.

Ai nuk i pranon botëkuptimet dhe predikimet hipokrite e boshe të hoxhallarëve, por reagon nga pozitë e një bektashiu me pikëpamje liberale dhe të njeriut human lidhur me pozitën e femrës në shoqëri. Me këto pikëpamje, Dajë Haxhiu ka ndikuar në formimin e personalitetit të Dijes. Ashtu siç do të dëshironte shkrimtari të ndikojë në formimin e botëkuptimit të Dijes, Dajë Haxhiu ndikoi në shumë çështje t'i vlerësoj drejt, objektivist. Veç ndjenjës personale, që u lind nga realiteti, nga rrethanat jetësore të Dijes, Dajë Haxhiu ndikoi në botëkuptimin e saj lidhur me pozitën e femrës në shoqëri, lidhur me moralin dhe nderin dhe sidomos lidhur me botëkuptimin për aktin e vetëvrasjes. Dajë Haxhiu, duke e konsideruar vetëvrasjen si krimin më të rëndë dhe si aktin më të pamoralshëm, ndikoi të Dija që edhe ajo të mendoj po si ai për këtë dukuri të shëmtuar shoqërore. Vizionin personal për të ardhmen, Stërmilli e thadroi në personazhin e Dajë Haxhiut. Në vitin 1936 Dajë Haxhiu, respektivisht Stërmilli, parasheh që brenda një kohe të shkurtër do të bëhen transformime të mëdha shoqërore. Ai, si edhe shumë të tjerë, e parasheh rrënimin e botës së vjetër dhe lindjen e botës së re. Vizioni i tij u realizua vetëm pas nëntë

vjetësh(me fitoren e Luftës Nacionalçlirimtare) dhe m'u këtu , në verifikimin e tij, qëndron rëndësia, pasha e vizionit për të ardhmen.

Dajë Haxhiu është njohës i mirë i jetës, i situatës politike e shoqërore në vend e në botë. Me forcën e arsyes e me fuqinë e logjikës konkludon : *mbrenda këtyre vjetëve,me deomos,do të shembët bota e vjetër e do të krijohet bota e re*<sup>6</sup>.

### **3.5.Roli i familjes së Xha Simonit**

Familja e Xha Simonit, e sidomos Irena- vajza e Xha Simonit- zë vend të dukshëm në këtë roman.Me këtë familje Stërmilli deshi të realizojë dhe i realizoi dy qëllime me rëndësi jomodeste në jetën shoqërore e familjare të popullit të vet. Së pari, me kontaktet që familja e Xha Simonit i kishte qëherët , atëherë kur jetonte në një nga qytetet e Kosovës, me familjen e Dan Rufesë-me të atin e Shpendit dhe, mandej, me marrëdhëniet që i kishte me familjen e Sulë kërthizes, e sidomos me Dijen, Stërmilli i theu paragjykimet e izolimit të familjeve të shqiptarëve në baza fetare.Stërmilli nuk e mori rastësisht familjen e Xha Simonit me besim të krishterë dhe familja e Dan Rrufesë me besim mysliman.Me shembullin e marrëdhënieve të këtyre dy familjeve shqiptare të besimeve të ndryshme dhe me kujdesin vëllazëror e prindor të familjes së Xha Simonit për Dijen,kush e di për satën herë në letërsi dhe nëpraktike Stermilli argumentoi se përkatesitë e ndryshme fetare nuk kanë qenë shkak i ndarjeve dhe i raporteve të këqija ndërfamiljare e ndërnjerëzore në popullin shqiptar.Madje, as frika e Dijes,siç është theksuar, se mos Shpendi është i krishterë,nuk e ka këtë bazë.Sa për Dijen,Shpendi mund të ishte edhe i krishterë dhe ajo do ta dashuronte po me atë forcë që e dashuroi atë si mysliman që ishte,por ishte e bindur se do të kishte pengesa edhe më të mëdha nga i ati të martohet me të sikur të ishte i krishterë.Së dyti me familjën e Xha Simonit,Stërmilli deshi të prezentojë një familje ideale shqiptare, një familje model,një familje moster për familjet e tjera shqiptare.Në këtë familje Stërmilli i grumbulloi të gjitha vetitë pozitive të raporteve e të moralit familjar e shoqërore dhe , në këtë mënyrë, manifestoi kultin ndaj familjes, siç e ndeshim edhe në letërsitë e kombeve të tjera, e sidomos në krijimet e Tolstoit.Stërmilli e hulumtoi me kompetencë familjen shqiptare

---

<sup>6</sup>Aty,f.146

dhe në të hetoi individë, grup individësh dhe terësi familjare që mund të jenë model si duhet të jenë individët, grupet individeve të familjes çfarë nuk duhet të ketë familja shqiptare, në anën tjetër. Pra, në këtë roman na jepen dy grupe të familjes ajo e cila e lë më shumë fanatizëm e injorancë një shoqëri, ajo familja e Sulë Kërthizes , për shkak të këtij lloji njerzish shumë viktima do të bien, si ajo e Dijes. Dhe familja e llojit të dytë e kemi atë të Xha Simonit, një familje plotë idealesh që shpreh aspirate të larta, një grup individesh që i nevojitet botës shqiptare shumë, për të përparuar, pra për të bërë ca hapa më shumë përpara, sepse nevoja po e kërkonte atë, një familje që e do të bijën e tyre dhe e dëshiron shkollimin e duhur për bijat e tyre, dhe të cilët nuk dëshirojnë që bijat e tyre të bien viktima të fatkeqësive për shkak të tyre. Në familjen e grupit të parë nuk kemi harmoni, lumturia nuk egziston tek ata, harmoninë e lumturinë mund ta shohim të familja e Xha Simonit, ata krijojnë ngrohtësi familjare, mirëkuptim, ata përfaqësojnë brezin e ri të shqiptarëve, ndërsa njerëzit si Sulë Kerthiza dhe gruaja e tij përfaqësojnë brezin e vjetër të shoqërisë.

### **3.6. Roli i Irenës në formimin e Dijes**

Në jetën e kryepersonazhit-të Dijes , Irena është personazh shumë i rëndësishëm. Pa Irenën, Dija nuk do të ishte ajo që është, nuk do ti kishte konceptët e njejta, pikëpamjet që i ka për botën, shoqërinë, për individët. Shkalla e arsimimit të saj deri të mesimi i gjuhëve të huaja i dedikohet Irenës. Ajo ia zgjeroi Dijes horizontet e njohurisë, i ndihmoi për përvetësimin e ideve përparimtare për çdo gjë. Irena çfarë mësonte në shkollë ia tregonte Dijes, po ashtu i ndihmoi edhe me literatura më të gjëra. Irena e bëri këtë punë me vetëmohimin e me vetëdije të lartë njerëzore. Dhe, më në fund, sikur të mos ishte Irena, po të mos ishte familja e Xha Simonit, Dija jo vetëm që nuk do të ishte ajo që është, por nuk do të kishte se si të takohej, të njihej, të dashurohej e ta lidhte jetën për vdekje me Shpendin. Kjo, në të njëjtën kohë fati e lumturia më e madhe e Dijes dhe vuajtja e tragjika e saj.

Megjithatë, jeta e Dijes nuk është vetëm tragjike individuale, por është, në të njëjtën kohë, edhe tragjike shoqërore. Tek Dijsa është thadruar një realitet tipik i një kohe të caktuar të historisë sociale, që vazhdoi të jetë dukuri deri vonë. Ky roman është një dokument letrar i një gjendjeje, i një raporti të rëndësishëm shoqëror, i një kohe të caktuar, i një kohe gati të kaluar.

Me romanin “Sikur të isha djalë”, Stërmilli qëndron pranë popullit, në mes të tij. Përmes ditarit të Dijes, Stërmilli pasqyron botëkuptimin primitive të familjes patriarkale, e cila helmohet kur në të lind një vajzë. Mandej, dashuria, martesja e vajzës pa dëshirën e saj, janë strumbullari i këtij roman.

## KAPITULLI I KATËRT

### 4.Gjuha dhe figuracionet në roman

Edhe me stil- me mjete stilistike,figurative, e edhe me gjuhë, me romanin “Sikur të isha djalë”,Stërmilli qëndron shumë afër popullit.Pa stërhollime stilistike dhe shpesh me frazeologji popullore, si p.sh *Femia pa nënë, si nata pa Hanë, i erdhi shpirti në majë të hundës, guri asht shumë i rand në vend të vet, Dridhet si thupra në ujë, të preftë kolera,Të përtaftë mordja,Të martë murtaja,t’u thafshin duert,mos dalsh në fat kurrë,Mos e prufsh kryet*,Stërmilli arrin ta paraqesë jetën faktike dhe disponimin e ngarkimin shpirtëror të personazheve. Me fjalë të qarta,shpesh të marra nga shprehja popullore, *si i lava duert* etj. Dija flet për jetën e vet, edhe pse figurativisht , në mënyrë të qartë, pra, pa metaforikë e simbolike të errët.Ajo flet thjesht,përdorë frazeologji e fjalë adekuate dhe, në shikim të parë, në mënyrë të qetë,por realiteti jetësor e gjendja shpirtërore për të cilat flet,ligjërimin e saj e bëjnë dramatik,tronditëse dhe në këtë mënyrëpoetizohet besnikëria, aq më parë kur poetike është edhe ngjarja,poetike janë edhe personazhet,poetikështë edhe vetë shkrimtari. Përmes rrëfimit të Dijes shprehet,gjithashtu, fryma patriarkale e shoqërisë shqiptare,në njerën anë dhe fryma humane,thellësisht njerëzore e kësaj shoqërie, në anën tjetër, së cilës i kundërvihet injoranca e fanatizmi. Fjalët e Dijes janë me ngarkesë të madhe emocionale të cilën e realizon me fjalë të rëndomtë që shpreh mendime e ndjenja personale dhe mendime e ndjenja të autorit dhe të opinionit të gjerë.

Në rrethanat jetësore dhe në gjendje shpirtërore e fizike të Dijes ndërhyjnë edhe sëmundja,që,gjithsesi, është pasojë e kësaj jete,e cila,si kategori e së keqës,ndikon në mënyrë vendimtare në përfundimin tragjik të Dijes, por edhe në gjuhën, në stilin lirik të rrëfimit të saj. Kështu, me romanin “Sikur të isha djalë”, Stërmilli arriti të realizojë me sukses një lirizëm shprehës që e mbanë lexuesin në gjendje të tendosur shpirtërore dhe e bënë ta lexojë veprën,siç thuhet, me një frymë. Por, me gjithë këtë lirizëm depërtues,Dija nuk arriti t’ia zgjojë ndërgegjenen babait dhe njerësisht, nuk arriti të mposhtë injorancën e fanatizmin e tyre.Narracioni i Dijes personazh e autor ka intonacion lutës të gershëtuar me anë qortues e shpesh të zemëruar, të mllëfosur,për pozitën e vet dhe për pozitën e femrës shqiptare në pergjithësi. Asnjë personazh tjetër në letërsinë shqipe nuk lutet aq shumë,nuk kërkon ndihmë aq shumë prej individëve e prej shoqërisë së Dija për ta shpetuar atë dhe gjithë femrat e tjera.



Prandaj, stilin e romanit “Sikur të isha djalë” dhe krejt strukturën poetike të tij e karakterizon fryma lutëse, në radhë të parë, mandej ajo polemizuese dhe qortuese. Në këtë mënyrë, toni lutës, polemizues dhe këshillat bëhen mjete me të cilat arrihet përmbushja ideore.

Dija polemizon me rrethin e ngushtë familjar, me individë, me shoqërinë, me një sistem të caktuar shoqëror-politik, elemente këto të cilat e bëjnë romanin “Sikur të isha djalë” shumëdimensional në këtë plan.

Ky roman i Stërmillit ka tiparet e një proze sentimentale me meditime të shumta e përshkrime të imta të vuajtjeve e të dashurisë, por edhe me shprehje moralizuese e deklarime retorike, të cilat i japin asaj ngjyra pak artificiale dhe mangësi në zbërthimin psikologjik të personazheve. Megjithatë, aty ka mjaft ndjenjë e dhembje të sinqertë, gjë që e tërheq lexuesin. Këto tipare lidhen, në radhë të parë me natyrën artistike të Stërmillit si shkrimtar sentimental. Po, duke qenë se ato ndihen edhe në disa prozatorë të tjerë të viteve `20-`30 si Postoli, Grameno, deri diku edhe te Spase etj., mund të themi se janë edhe tipare të prozës sonë ende të dobët, e cila në këtë kohë megjithëse përpiket të trajtojë probleme shoqërore të rëndësishme të realitetit shqiptar, mbeti sentimentale. Dija është personazhi më i realizuar në roman, me një botë të bukur shpirtërore, me një psikologji të qartë dhe natyrë tërheqëse. Ajo i kundërvihet krejtësisht mjedisit ku u rrit dhe demaskon gjithë mënyrën e organizimit të jetës familjare e shoqërore shqiptare.

Gjithnjë e hajthme, e dobët, e trishtuar, e zhytur në mendime të zymta e munduar nga pamundësia për t’u takuar me të dashurin e saj Shpendin, dhe me parandjenja se gjithçka do të përfundonte keq, e fyer vazhdimisht nga njerka e saj, e fyer nga i ati, e papërfillur dhe e përbuzur nga shoqëria, ajo sëmuret rëndë nga turbekulozi dhe vdes, pak kohë pasi e kanë martuar me përdhunë. Edhe përpjekjet e disa njerëzve me pikpamje përparimtare të fisit të saj, edhe përpjekjet e Shpendit për ta rrëmbyer e për të ikur nga Shqipëria dështojnë. Fati i çdo vajze ishte i përcaktuar; nënshtrimi dhe bindja ndaj ligjeve patriarkale, mbytja e dëshirave dhe e dashurisë, ndryshe e priste turpërimi dhe asgjësimi fizik. Por kjo kundërvënie tragjike e humbet, deri diku, forcën e saj për shkak të disa dobësive artistike të romanit siç janë p.sh. mendimet e zgjatura, arsyetimet moralizuese; që janë dhënë nga pozita sentimentale e jo realiste, të cilat shpesh zëvendësojnë veprimin konkret të personazheve me ankime, psherëtima etj. Megjithatë vepra, sidomos në kohën kur doli, e tronditi opinionin publik dhe pati një jehonë të madhe të lexuesi shqiptar, pasi heroína e tij tregohet e vendosur në luftën e

vet kundër botës së vjetër, kundër normave etiko-morale të saj, pavarësisht se nuk arrinë dot dhe s'kishte se si, në mënyrë individuale, të gjente një rrugëzgjdhje për një problem aq të rëndësishëm shoqëror. "Duhet të luftojmë në daçim të rrojmë si njerëz" - shkruan ajo në ditarin e saj. Por dihet qëindividualja ndaj shoqërisë është gjithmonë dramatike ose tragjike. Asnjë mjet, asnjë motiv që sjell autori në vepër, nuk e shpëton dot. As largimi nga vendi. Kritika ka pohuar disa herë që autori nuk arrinë të sjellë një zgjidhje të drejtë me arratisjen e Dijes dhe Shpendit jashtë vendit. Po, në të vërtetë, ky nuk është një gjykim i saktë. Autori pikërisht duke sjellë dështimin e kësaj përpjekjeje, i tregon lexuesit se s'mund kurrsesi që kjo të jetë zgjidhja. Ky motiv është ndoshta nga më realistët në roman. Jo ikja nga e keqja, po përplasja e lufta me të mund të sjellin ndryshime në ligjet dhe opinionin e egër e të prapambetur shoqëror.

#### 4.1.Gjuha e Dijes

Gjuha e Dijes është mjaftë meditative për moshën që i takon, ajo është vetëdijshme për gjendjen e saj të rëndë dhe për të tjerat vajza myslimane që e kanë fatin si të saj.Këtë na e jep vet ajo drejtpërdrejtë: *Femra myslimane, e mbyllun mbrenda katër mureve,asht e mpitë ,e dobët dhe e pazhdrivillueme, sepse asht shtypne e mbytë nga zgjedha e rande e një edukate qe nuk këshillon e nuk porosit tjetër veçse ndalime : mos prek,mos dil,mos fol,mos qesh, mos e mos sa të dojëedukatori*<sup>7</sup>. *Ashtë e dobët, pse nuk merr mjaft ajr,nuk e shef diellin, nuk leviz, nuk i kollot sytë në bukuritë e natyrës dhe qesh më pak e qanë më shumë. Me një fjalë asht një krijesë fatkeqe qëta këput shpirtin sikur të mundet me e shprazë venerin e zembrës për padrejtesitë që i bahen*<sup>8</sup>. Në këtë paragrafë të dytë kemi po ashtu një metafore të qëlluar nga vet Dija,edhe pse e re në moshë flet sikur të ishte në një moshë më të madhe.Shkrimtari i ka falur një botëkuptim të gjërë dhe po ashtu ia ka falur një mençuri qe ti vë gjërat në peshore.Dija i bën vetit një krahasim kur atë e mbulojnë me ferexhe,ajo më tani nuk ka se me kë të loz,nuk ka për të dalur më jashtë

---

<sup>7</sup>Aty fq.25

<sup>8</sup>Aty fq.25

shtëpisë tani do jetë më afër njerkes së saj, veç kësaj vetja i duket edhe e frikshme me atë ferexhe dhe e tmershme sa bën krahasim: *''Me gjante vetja plotësisht si sorrë e zezë, por pak e gjatë''*. Mençuria e Dijes thotë që një grua dhe një burrë për t'u martuar ata në fillim duhet të njoftohen e të shikojnë nëse përputhen me karaktere e personalitet. Por këtë e kanë të ndaluar femrat myslimane. Gjuha e Dijes gjithmonë është plotë plogështi, e plotë zhgënjim e gjithmonë me ndjenja të sinqerta, mendime thellësisht njerëzore. Gjuhën që e përdori Dijs la mbresa të pashlyeshme, e krijoi po ashtu portretin e vet moral e etik të një krijese sa humane, aq edhe tragjike.

## KAPITULLI I PESTË

### 5.Studiuesit albanologjik për romanin “Sikur të isha djalë”

#### 5.1.Robert Elsie për romanin

Si një nga romanet më popullore shqiptare të viteve të tridhjeta, “Sikur të isha djalë” është e para vepër e rëndësishme në letërsinë shqiptare me temën e emancipimit të gruas<sup>9</sup>.Shumë vajza shqiptare të kohës u ulën e mësuan shkrim e lexim siç thuhet vetëm e vetëm që të mund të lexonin këtë libër.Ai është ndër romanet e para shqiptare në formë ditari, çka i jepte dorë të shtjellonte karakteret e protagonistëve me një monolog dramatik të fuqishëm.Elsie thekson poashtu se ndonëse në përgjithësi bindes ne ide dhe i pasur me elemente leksikore të dialektit të gegërishtes së mesme të autorit,romani prapëseprapë nuk ka shpëtuar nga shumë dobësi stilistike,të cilat bëjnë të mos ngrihet deri në shkallën e një letërsie të madhe<sup>10</sup>, kështu shprehet Elsie.Ai është shkruar me një stil narrativ shumë realist plotë psherëtima romantike, pasthirrma e mallkime, kështu vazhdon Elsie për romanin.Me gjithë qëllimin e mirë për ta nxitur lexuesin që të ndalej e të mendonte për një problem social të rëndësishëm, Stërmilli nuk ishte në gjendje të kapërcente sentimentalizimin lotndjellës të kohës, të cilin ai e ndihmoi të rrënjosej në letrat shqiptare.Për këtë arsyeje, “Sikur të isha djalë”, revolucion modest për mesin e viteve tridhjetë, do të vjetërohej shpejt si vepër letrare, këtë e tha Elsie si perfundim.Megjithatë ky roman u mirëpritë më shumë interes në Kosovën e pasluftës,ku pozita e gruas në shoqëri nga shumë aspekte ngjante me pozitën e gruas në shoqërinë e Shqipërise së kohës së shkruar në roman.

---

<sup>9</sup>Robert Elsie, Historia e Letërsisë Shqiptare,Dukagjini,Pejë,2001 fq.174

<sup>10</sup>Robert Elsie, Historia e Letërsisë Shqiptare,Dukagjini,Pejë,2001 fq.174

## 5.2.Sabri Hamiti për romanin

Sabri Hamiti thekson se romani “Sikur të isha djalë” ka një vlerë, se rroket me temen e shoqërisë së kohës,për dallim nga proza romanseiere e mëhershme e shqipes,që rrokej kryesisht me tema të së kaluares, të tipit atdhetar e heroik, të cilat mbështeteshin në anekdota ose pseudohisori<sup>11</sup>.Poashtu thekson se autori dëshmon se proza e romanit ka mundësinë që me sjelljen e fakteve të jetës t’i afrohet më shumë realitetit të kohës.Pra, që letërsia të rinjitet si rikrijuese e ambientit të vet autentik.

Mangesitë kryesore të romanit “Sikur të isha djalë” janë varfëria e shprehjes letrare dhe mungesa e paraqitjes së veprimeve.Mangësia në shprehje letrare është kushtëzuar edhe nga shkrimi i veprës si ditar i një femre<sup>12</sup>. Vepra duke qenë e shkruar si ditar,madje si ditar që përpiqet ta tregojë edhe jetën e kaluar,nuk janë veprime por më shumë komente dhe rrëfime për të ndodhurat në të kaluarën.

---

<sup>11</sup>Sabri Hamiti,Letërsia Moderne, Faik Konica, (Prishtinë) 2002 fq 424

<sup>12</sup>Sabri Hamiti,Letërsia Moderne, Faik Konica, (Prishtinë) 2002 fq 424

## PËRFUNDIME

Haki Stërmilli është shembulli krijues sidomos i romanit në formë ditari. Ai e ngriti lartë këtë formë proze duke i hapur rrugë të reja shkrimtarëve pasues. Proza e Stërmillit ka tiparet e një proze sentimentale me meditime të shumta e përshkrime të imta të vuajtjeve e të dashurisë, por edhe me shprehje moralizuese e deklarime retorike, të cilat i japin asaj ngjyra pak artificiale dhe mangësi në zberthimin psikologjik të personazheve. Megjithatë, aty ka mjaft ndjenjë e dhembje të sinqertë, gjë që e tërheq lexuesin. Këto tipare lidhen, në radhë të parë me natyrën artistike të Stërmillit si shkrimtar sentimental.

Me romanin “Sikur tëisha djalë” ai i bëri jehonë levizjes shoqërore për të drejtat e gruas në shoqëri, ku aty u pasqyrua gjerë e gjatë e në menyrë të drejtpërdrejtë tema aktuale e kohës. Ai bëri emër të madh e të veçantë me krijimin e këtij romani të bukur me nota sentimentale, Romani “Sikur të isha djalë” është ndoshta i vetmi roman “më i shitur” me ribotimet periodike nëpër vite. Romani është një apoteozë e fuqishme artistike për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të femrës në veçanti. Ai zgjoi kërshtëri dhe luajti një rol të pazëvendësueshëm në masën e lexuesve në të gjitha trevat shqiptare. Në vitet '30, në vitet '50 dhe deri në dhjetëvjeçarin e parë të Shek. XXI.

Në krijimtarinë e tij ndihet veçanërisht fati tragjik i luftëtarit për liri, i cili e sheh krijimin dhe vijimësinë e jetës familjare të lidhur ngushtë me lirinë kombëtare dhe fatet e atdheut. Por Stërmilli është gurëthemeli edhe në atë që quhet letërsi dokumentare. Shënimet, kujtime dhe ditaret e tij në librat “Burgu” dhe “Shtigjet e lirisë” nuk janë thjeshtë memorie sociale e gjysmës së parë të Shek. XX, por edhe fjalë letrare, elegancë dhe sinqeritet, kulturë dhe talenti i të shkruarit. Uniteti dhe vijimësia e jetës dhe reflektimi i tyre në procesin letrar janë gjithashtu një dëshmi unike e Stërmillit që nga skicat dhe tregimet e para të moshës djaloshare dhe deri te radhet e dorëshkrimit të tij të fundit, ndihet jeta dhe lufta e njeriut të thjeshtë.

Prandaj, si permbyllje modeste të këtij punimi, konstatojmë se Haki Stërmilli i dha diçka ndryshe letërsisë shqipe. Ai dha një realitet të ngjeshur në veprën e tij. Një dëshmitar meditues vet atij realiteti.

## **BIBLIOGRAFIA**

### **(Literatura)**

- 1.Kajtaz Recaj,Krijimtaria letrare e Haki Stërmillit, Prishtinë,1988
2. Resmije Kryeziu, Personazhi i gruas në letërsinë shqipe, mes dy luftërash,Prishtinë,1988
2. Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare,Dukagjini,Pejë, 2001
- 3.Sabri Hamiti, Vepra letrare 8, Letërsia Moderne,Faik Konica,Prishtinë,2002
- 4.Wikipedia.























